



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/Republic of Kosovo  
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality  
KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH



Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 shkronja o) dhe neni 40 paragrafi 40.2 shkronja i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), dispozitave të Ligjit nr. 04/L-071 për Sistemimin e Adresave, neni 32 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt. 11.09.2008, në seancën e XII-të të Kuvendit të Komunës së Dragashit e mbajtur me dt. 18.12.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miratohet ky:

## V E N D I M

### PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE, SHESHEVE DHE LAGJEVE NË KOMUNËN E DRAGASHIT

#### Neni 1

**Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit.

#### Neni 2

Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, ku 3 (tre) anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës dhe 2 (dy) anëtar janë nga ekzekutivi i komunës, si në vijim:

- 2.1 Shpetim Hajredini – PDK, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
- 2.2 Anesa Mehmeti – LDK, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
- 2.3 Edin Kurt – JGP, anëtar nga Kuvendi i Komunës;
- 2.4 Fari Kolloni - anëtar nga ekzekutivi i Komunës;
- 2.5 Isljam Redzepllar - anëtar nga ekzekutivi i Komunës.

#### Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga palët e pakënaqura për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Dragashit dhe të vendos sipas kushteve, kriterëve dhe procedurave të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemimin e Adresave dhe akteve tjera nënligjore në fuqi.

#### Neni 4

Obligohet komisioni që me konsensus të brendshëm të anëtarëve të për zgjedh kryesuesin e komisionit të ankesave dhe procesmbajtësin.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

#### Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

**KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH**

01 Nr. 060/01-31085-5/24

Dt. 18.12.2024

Kryesuesja e Kuvendit  
Arijeta Skeraj

